

Plani Strategjik 2026-2030

basketbolli30

**Loja që na bashkon,
vizioni që na frymëzon**



basketbolli30

Loja që na bashkon,
vizioni që na frymëzon

Plani Strategjik 2026-2030



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

Tabela e përmbajtjes

•	Parathënia e Kryetarit	3		
—				
•	Mesazhi i Sekretares së Përgjithshme	4		
—				
00	Përmbledhja ekzekutive	5	05	Konteksti strategjik 19
—			—	
01	Basketbolli 3.0 – Korniza strategjike	7	06	5 qëllimet e Basketbollit 3.0 2026-2030 20
—			—	
02	Vizioni, Misioni	8	07	Basketbolli 3x3 24
—			—	
03	Vlerat	9	08	Synimet 2026-2030 26
—			—	
04	Nga Strategjia 2021-2025 në Basketbolli 3.0	10	•	Përmbyllje 32

PARATHËNIA E KRYETARIT

TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS



Arben Fetahu

Me ndjenjë përgjegjësie dhe besimi në të ardhmen, prezantojmë Planin Strategjik të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) për periudhën 2026-2030, të ndërtuar mbi përvojën tonë institucionale, bashkëpunimin e vazhdueshëm me FIBA-n dhe angazhimin e gjerë të komunitetit të basketbollit.

Ky dokument është më shumë se një plan strategjik. Ai përfaqëson një angazhim të përbashkët, një deklaratë të qartë të drejtimit ku synojmë ta çojmë basketbollin në Kosovë dhe një vizion të përbashkët për mënyrën se si ky sport do të zhvillohet, do të përjetohet dhe do të përfaqësojë vendin tonë në vitet që vijnë.

Strategjia e mëparshme 2021-2025 vendosi themele të forta për zhvillimin e basketbollit, duke forcuar strukturat organizative, duke zgjeruar pjesëmarrjen, duke rritur kapacitetet

njerëzore dhe duke ndërtuar besueshmëri në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky progres nuk ishte i rastësishëm, por rezultat i planifikimit të qëndrueshëm, bashkëpunimit dhe vizionit të përbashkët.

Sot, mbi këto themele, hyjmë në një fazë të re zhvillimi. Basketbolli 3.0 përfaqëson këtë moment transformimi: një qasje moderne që e sheh basketbollin jo vetëm si sport garues, por si përjetim, komunitet dhe forcë bashkuese për shoqërinë.

Vizioni ynë është i qartë: të zhvillojmë basketbollin në Kosovë përmes përfshirjes, cilësisë dhe qëndrueshmërisë, duke krijuar mundësi reale për vajzat dhe djemtë, duke zhvilluar talente, duke forcuar ekipet kombëtare dhe duke ndërtuar një trashëgimi afatgjate për brezat që vijnë.

Federata e Basketbollit të Kosovës merr përgjegjësinë e plotë për udhëheqjen dhe zbatimin e kësaj strategjie në partneritet me të gjitha grupet e interesit.

Kjo strategji është një ftesë e hapur për të gjithë aktorët e përfshirë në basketboll, klube, trajnerë, lojtarë, institucione, partnerë dhe komunitet, për të ecur së bashku drejt këtij vizioni. Vetëm përmes unitetit, bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët, ambicia mund të shndërrohet në realitet.

MESAZHI I SEKRETARES SË PËRGGJITHSHME

TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS



Elvira Dushku

Strategjia 2026-2030 e Federatës së Basketbollit të Kosovës përfaqëson një dokument orientues për fazën e radhës së zhvillimit të basketbollit në vendin tonë. Ajo është rezultat i një procesi të thellë analize, reflektimi dhe konsultimi, i mbështetur në përvojën e zbatimit të Planit Strategjik 2021-2025 dhe në bashkëpunimin e strukturuar me FIBA-n në kuadër të programit FIBA Plus.

Ky dokument ndërtohet mbi bindjen se zhvillimi i qëndrueshëm nuk vjen nga veprime të izoluar, por nga sisteme të ndërlidhura mirë, prioritete të qarta dhe qeverisje të mirë. Strategjia 2026-2030 nuk fokusohet vetëm në atë çfarë do të bëjmë, por edhe në, si dhe pse do ta bëjmë.

Basketbolli 3.0 përfaqëson kornizën strategjike të këtij cikli: kalimin nga

menaxhimi i aktiviteteve drejt ndërtimit të një ekosistemi të qëndrueshëm, nga fokusi në rezultate afatshkurtra drejt krijimit të vlerës afatgjate dhe nga zhvillimi sportiv drejt ndikimit më të gjerë shoqëror dhe ndërkombëtar.

Gjatë periudhës 2026-2030, FBK do të fokusohet në forcimin e sistemeve kyçe të zhvillimit: edukimin e trajnerëve, zhvillimin e talentëve, rritjen e pjesëmarrjes së vajzave, zgjerimin e komunitetit të basketbollit dhe forcimin e ekipeve kombëtare. Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu zhvillimit të disiplinës 3x3, si një prioritet strategjik drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 dhe përtej tyre.

Kjo strategji është konceptuar si një dokument i gjallë, që kërkon angazhim të vazhdueshëm, transparencë dhe

bashkëpunim të gjerë për t'u zbatuar me sukses. Ajo synon të shërbejë si pikë reference për të gjithë aktorët e përfshirë dhe si udhërrëfyes për vendimmarrjen strategjike të Federatës së Basketbollit të Kosovës në vitet që vijnë.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE



Plan Strategjik i Federatës së Basketbollit të Kosovës për periudhën 2026-2030, i titulluar "Basketbolli 3.0 - Loja që na bashkon, vizioni që na frymëzon", përfaqëson fazën e radhës të zhvillimit të basketbollit në Kosovë. Ky dokument strategjik përcakton drejtimin afatgjatë të Federatës, duke ndërtuar mbi arritjet e periudhës së kaluar dhe duke vendosur themele të qëndrueshme për rritje, cilësi dhe përfshirje në të gjitha nivelet e lojës.

Gjatë ciklit strategjik 2021-2025, Federata e Basketbollit të Kosovës ka shënuar progres të dukshëm në forcimin e strukturave organizative, rritjen e pjesëmarrjes, avancimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e imazhit institucional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto arritje kanë dëshmuar se zhvillimi i qëndrueshëm nuk është rezultat i rastësishëm, por i vizionit të qartë, planifikimit të strukturuar dhe bashkëpunimit me të gjitha palët e interesit. Strategjia 2026-2030 ndërtohet mbi këtë bazë, duke reflektuar mësimet e nxjerra dhe duke adresuar sfidat dhe mundësitë e reja që ka përpara basketbolli kosovar.

Në këtë kontekst, Basketbolli 3.0 përfaqëson një qasje moderne dhe gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të

sportit, ku fokusi nuk është vetëm te rezultatet sportive, por edhe te edukimi, qeverisja e mirë, përfshirja sociale, barazia gjinore dhe ndërtimi i komunitetit. Strategjia synon ta pozicionojë Federatën e Basketbollit të Kosovës si një organizatë të pjekur, transparente dhe të orientuar drejt standardeve më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Vizioni i kësaj strategjie është zhvillimi i basketbollit në Kosovë si një sport gjithëpërfshirës, cilësor dhe i qëndrueshëm, që kontribuon në zhvillimin shoqëror, fuqizon të rinjtë dhe vajzat, dhe përfaqëson Kosovën me dinjitet në arenën ndërkombëtare. Ky vizion realizohet përmes një misioni të qartë për ndërtimin e kapaciteteve njerëzore, forcimin e sistemeve zhvillimore dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në basketboll.

Strategjia 2026-2030 bazohet në pesë qëllime strategjike kryesore, të cilat përbëjnë shtyllat e Basketbollit 3.0: edukimi i trajnerëve si themel i cilësisë, zhvillimi i talentëve përmes një rruge të qartë progresi, fuqizimi i vajzave dhe grave në të gjitha nivelet e basketbollit, ndërtimi i një komuniteti të gjerë dhe gjithëpërfshirës të basketbollit, si dhe forcimi i ekipeve

kombëtare përmes strukturave të qëndrueshme dhe identitetit të qartë sportiv.

Një prioritet i veçantë strategjik i kësaj periudhe është zhvillimi i basketbollit 3×3, i identifikuar si disiplinë kyçe drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Për këtë qëllim, Federata ka hartuar një plan të veçantë strategjik për 3×3, të integruar me strategjinë e përgjithshme, duke synuar ndërtimin e kapaciteteve profesionale, zhvillimin e lojtarëve elitare, strukturimin e ligës dhe infrastrukturës, si dhe forcimin e promovimit dhe partneriteteve.

Zbatimi i Strategjisë 2026-2030 mbështetet në një kornizë të qartë qeverisëse, mekanizma të monitorimit dhe indikatorë të matshëm të performancës, të cilët sigurojnë llogaridhënie, transparencë dhe progres të vazhdueshëm. Federata e Basketbollit të Kosovës e konsideron këtë strategji si një dokument, i cili do të udhëheqë vendimmarrjen dhe veprimet e saj gjatë gjithë periudhës katërvjeçare.

Për të siguruar transparencë, vazhdimësi dhe matshmëri, kjo strategji mbështetet në analizën e objektivave të periudhës 2021-2025 dhe përfshin një përmbledhje të qartë të qëllimeve strategjike 2026-2030.

Kjo strategji është një thirrje për bashkëpunim dhe angazhim të përbashkët të të gjithë aktorëve të basketbollit: klubeve, trajnerëve, lojtarëve, institucioneve publike, partnerëve dhe komunitetit, për ta shndërruar vizionin e Basketbollit 3.0 në realitet dhe për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme për basketbollin në Kosovë.



1. BASKETBOLLI 3.0


– Korniza strategjike

Basketbolli 3.0 nuk është slogan. Ai është korniza strategjike dhe vendimmarrëse mbi të cilën Federata e Basketbollit të Kosovësdo të ndërtojë zhvillimin e saj gjatë periudhës 2026-2030.

Kjo qasje mbështetet në tri parime themelore:



Transformim
- zhvillim i sistemit nga baza drejt një ekosistemi funksional dhe të qëndrueshëm



Përfshirje
- basketbolli për të gjithë, në çdo komunitet dhe në çdo nivel



Inovacion
- qasje moderne në organizim, formate, komunikim dhe përvojë sportive

Në epokën e Basketbollit 3.0:

Loja bëhet përjetim

Përjetimi krijon identitet

Identiteti ndërton histori dhe trashëgimi

Çdo prioritet strategjik, program dhe investim do të vlerësohet përmes tri pyetjeve udhëzuese:

- A e transformon sistemin?
- A e rrit përfshirjen reale?
- A krijon vlerë të qëndrueshme përtej ciklit strategjik?

2. VIZIONI, MISIONI

VIZIONI 2030

Ta avancojmë basketbollin në Kosovë dhe ta shndërrojmë atë në një histori suksesi në të gjitha nivelet.

Si duket suksesi:
Deri në vitin 2030, Basketbolli 3.0 synon që:

Basketbolli të jetë sporti që bashkon komunitetet në Kosovë

Trajnerët, referët dhe talentet të zhvillohen në sisteme të strukturuar

Vajzat dhe djemtë të kenë qasje të barabartë dhe të qëndrueshme

Ekipet kombëtare të jenë konkurruese dhe krenari kombëtare

Kosova të njihet si destinacion modern sportiv.

MISIONI

**Ta qeverisim,
zhvillojmë dhe
rrisim sportin e
basketbollit në
Kosovë**

3. VLERAT

Vlerat themelore të Federatës së Basketbollit të Kosovës janë:

VIZIONI

Jemi vizionarë dhe kreativë, kemi ëndrra të mëdha dhe mendojmë vazhdimisht se si ta bëjmë basketbollin në Kosovë më tërheqës, më gjithëpërfshirës dhe më të zhvilluar për të gjithë pjesëmarrësit dhe grupet e interesit.

PASIONI

Jemi të apasionuar pas basketbollit, komunitetit dhe vendit tonë, dhe ky pasion reflektohet në çdo veprim dhe vendim tonin.

RESPEKTI

Respektojmë diversitetin dhe lirinë e mendimit dhe udhëhiqemi nga parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe përgjegjësisë në çdo nivel të veprimtarisë sonë.

ZELLI

Punojmë me përkushtim dhe angazhim të lartë për ta përmbushur misionin dhe vizionin tonë, duke besuar se asgjë nuk e zëvendëson punën e ndershme dhe të zellshme.

FITORJA

Jemi fitues dhe promovojmë një mentalitet fituesi tek lojtarët, trajnerët, zyrtarët, grupet e interesit dhe partnerët tanë, duke synuar vazhdimisht performancë dhe progres.

Në Basketbollin 3.0, këto vlera nuk janë vetëm deklaratata, këto udhëheqin vendimmarrjen dhe zbatimin e strategjisë.

4. NGA STRATEGJIA 2021-2025 NË

ba3ketbolli

Strategjia 2021-2025

shënoi fazën e ndërtimit të themeleve institucionale të Federatës së Basketbollit të Kosovës:

- Planifikimi strategjik u bë praktikë e qëndrueshme
- U ndërtuan struktura funksionale
- U forcuan programet zhvillimore
- U rrit besueshmëria ndërkombëtare.

Strategjia 2026-2030

shënon kalimin në fazën e konsolidimit dhe transformimit:

- Theks i qartë në cilësi, ndikim dhe standarde të qëndrueshme
- Fokus në zhvillim të qëndrueshëm dhe progres afatgjatë
- Ndërtim i vlerës afatgjatë përtej ciklit strategjik.
- Kjo është faza kur basketbolli në Kosovë hyn në pjekuri strategjike. Ky kalim përbën bazën mbi të cilën ndërtohen pesë qëllimet strategjike të Basketbollit 3.0.

Kjo është faza kur basketbolli në Kosovë hyn në pjekuri strategjike. Ky kalim përbën bazën mbi të cilën ndërtohen pesë qëllimet strategjike të Basketbollit 3.0.

Indikator	2021	2022	2023	2024	2025
01 Të hyrat totale(€)	800,000 /1.000.000	850,000	900,000	950,000	1,917,005.20
02 Të hyrat nga sektori publik (€)	350,000 /332,000	360,000	370,000	385,000	571,382
03 Trajnerë të kualifikuar	5/4	10	15	15	20
04 Trajnere të kualifikuara	2/0	3	5	7/5	10
05 Gjyqtarë të kualifikuar	4/5	5	5	6/7	8
06 Pjesëmarrës gjithsej (online)	2,000 /2,445	2,500 /2,000	3,000 /2,000	3,500 /2,000	4,000
07 Pjesëmarrës - meshkuj	1,500 /2,072	1,700 /1,600	1,900 /1,600	2,300 /1,600	2,600
08 Pjesëmarrës - femra	500 /373	700 /400	900 /400	1,100 /400	1,400
09 Pjesëmarrës - të rinj	1,000 /1,051	1,100	1,200 /1,100	1,400 /1,100	1,600
10 Numri i klubeve	125/111	130/121	135/127	140/145	145
11 Klube me strukturë rinore	20/21	25/89	30/89	35/95	40
12 Plane për zhvillim të klubit & komunitetit	5	7	9	12	15
13 Shkolla që bashkëpunojnë me Federatën	20/16	25/50	30/50	40/50	50
14 Tifozë në databazë	12,000/ COVID 19	14,000	16,000	19,000	22,000
15 Mesatarja e artikujve pozitivë / muaj	10/10	12/10	14/10	16/10	18

Basketbolli në shifra 2021-2025

Viti	Të ardhurat totale (€)	Të ardhurat nga sektori publik (€)
2021	1,232,607	338,375
2022	1,338,618	389,840
2023	2,152,416	1,135,147
2024	1,989,057	241,950
2025	1,917,005.20	571,382

Rritja e stafit të Zyrës Ekzekutive

Numri i stafit të Zyrës Ekzekutive të FBK-së është rritur **nga 8 në 15**, duke forcuar kapacitetet organizative dhe mbështetjen për zhvillimin e basketbollit në Kosovë.

Kosova Women's Basketball

Që nga viti 2023, FBK ka hapur kanale të dedikuara për basketbollin e femrave, duke i dhënë mundësi sportit të femrave të ketë prezencë të drejtpërdrejtë dhe fokus të veçantë në komunikim dhe promovim. **Gjatë vitit 2025**, profili i Kosova Women Basketball regjistroi **2,664 ndjekës** dhe zhvilloi një aktivitet të lartë digjital me **1,841 postime gjatë gjithë vitit**, duke rritur dukshëm prezencën, angazhimin dhe shtrirjen e përmbajtjes në audiencën online.

Fushatat mediale

Në vitet 2021-2025, Federata e Basketbollit të Kosovës ka realizuar një sërë iniciativash dhe fushatash mediatike me qëllim rritjen e vizibilitetit të garave, projekteve dhe aktiviteteve të saj, duke forcuar praninë publike dhe komunikimin me komunitetin sportiv. Numri i kampanjave kryesore:

Fushata ndërkombëtare:

31

Fushata vendore:

38

Projekte dhe programe:

14

Fushata të dedikuara për femra:

7

Email Marketing

Që nga viti 2025, Federata e Basketbollit të Kosovës ka filluar të përdorë email marketing-un si një kanal kyç për komunikimin me komunitetin e basketbollit, klubet, trajnerët, mediat dhe publikun e gjerë. Ky kanal ka shërbyer për informimin në kohë reale, rritjen e transparencës dhe forcimin e lidhjes me audiencën, duke ndërtuar një bazë kontakti të angazhuar dhe të qëndrueshme.

Kontakte totale

2,494

(nga të cilët 2,428 subscribers)

Emails të dërguar

52,690

Emails të hapur

13,886

Emails të dorëzuar

51,456

Klikime

333

Bounces

1,234

Podcast

Që nga viti 2025, FBK ka lansuar podcastin zyrtar, i cili gjatë periudhës prill-dhjetor 2025 ka shënuar rritje të qëndrueshme dhe ndikim të lartë në platformat digjitale. Podcasti ka gjeneruar mbi **2.5 milion impressions** (2,547,644), **1.8 milion reach** (1,867,639) dhe **1.4 milion views** (1,477,118).

Gjatë kësaj periudhe janë publikuar **378 postime**, që kanë rezultuar me mbi **25,100 pëlqime**, duke dëshmuar një angazhim të fortë të audiencës. **Përmbajtja organike** ka arritur mbi **1.3 milion persona**, ndërsa në **TikTok** janë regjistruar **456,320 shikime** dhe **237 ndjekës të rinj**. Në **YouTube**, kanali është rritur nga **7,700 në mbi 8,800 subscribers (+1,100)**, me **episodin e pestë** që ka shënuar performancën më të lartë me **7,087 shikime**.

Shifrat kryesore të mediave digjitale:

basketbolli.com



220,000 vizitorë aktivë

5.2 milion vizita

130 milionë vizita

1.2 milion bashkëveprim



facebook

4.6 milion shtrirje

8.7 milion vizita

Instagram



57 milionë vizita

1.2 milion bashkëveprim

8.2 milion vizita



YouTube

LinkedIn



560 ndjekës

1,150 ndjekës



X

TikTok



2,600 ndjekës

Seminaret për fuqizimin e klubeve

Në kuadër të përforcimit të strukturave drejtuese dhe rritjes së standardeve të menaxhimit sportiv, gjatë viteve 2021-2025 FBK ka ndërmarrë iniciativa të rëndësishme në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë për fuqizimin dhe profesionalizimin e klubeve të basketbollit në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar tre seminare me FIBA për zhvillimin e kapaciteteve të klubeve: dy seminare në vitin 2022, të fokusuar në qeverisje dhe menaxhim financiar të klubeve, dhe një seminar në vitin 2024. Po ashtu,

në 2024 u zhvillua edhe një seminar për "Qeverisje të Mirë në Sport" në bashkëpunim me Academy of Leadership Sciences Switzerland, duke ofruar njohuri strategjike dhe praktike për avancimin profesional dhe zhvillimin qëndrueshëm të klubeve të basketbollit në Kosovë. Këto iniciativa kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve menaxheriale dhe operacionale, duke forcuar strukturën organizative dhe qeverisjen e mirë brenda federatës dhe klubeve anëtare.

Ngritja e kapaciteteve

Për periudhën 2021-2025, Federata e Basketbollit të Kosovës ka vendosur theks të veçantë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, duke fuqizuar stafin administrativ, trajnerët, delegatët dhe strukturat udhëheqëse përmes angazhimit aktiv në iniciativa dhe programe zhvillimore ndërkombëtare. Programet kryesore: FIBA Time Out, MESGO, FIBA WiLead, JB NBA Workshops, FIBA Academy Strategic Leaders, FIBA European Youth Leadership, ASMC, FIBA Open 2025, SWISH, FIBA Women's Summit.

Numri total i pjesëmarrjeve:

61

Numri total i individëve të përfshirë:

38

Your Vision, Your Mission & Your Values

FIBA Plus



Klinikat & trajnimet për gjyqtarë

Gjatë periudhës **2021-2025**, FBK ka organizuar gjithsej

50

klinika

trajnime dhe procese licencimi për gjyqtarë, duke përfshirë klinika ndërkombëtare FIBA, programe të edukimit profesional, kampe zhvillimore për gjyqtarë fillestarë dhe perspektivë, si dhe programe të specializuara për sistemet DSS dhe STATS LIVE. Këto aktivitete kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së gjykimit, zhvillimin profesional të kuadrit të gjyqtarëve dhe forcimin e integritetit në basketbollin e Kosovës.



Aktet normative

Në periudhën kohore **2021-2025**, FBK ka miratuar

15

akte normative të reja

duke rritur numrin e tyre nga **18 në 33**. Përveç akteve të reja, të gjitha **18 aktet ekzistuese të vitit 2021 janë përditësuar** sipas nevojës dhe praktikave më të fundit, duke garantuar një kuadër ligjor dhe etik të përditësuar dhe funksional për të gjitha nivelet e basketbollit në Kosovë.

Programet & projektet kryesore të FBK-së



1. Sport në Shkolla

Target: Nxënësit e shkollave fillore; përfshin basketboll 3×3 si aktivitet ekstrakurrikular. Nis me 14 shkolla dhe rreth 900 nxënës, dhe vazhdon me 17 shkolla të tjera duke përfshirë rreth 1,200 nxënës të angazhuar.

2. Safeguarding the Future

Target: Trajnerët, lojtarët, stafi, gjyqtarët dhe klubet; projekt për mbrojtjen nga çdo formë abuzimi në sport dhe për promovimin e sigurisë dhe integritetit në basketboll.

3. SHOOTER

Target: Komuniteti i basketbollit; fokus në transformimin dixhital dhe inovacionin në sport.

4. Alley-OOP

Target: Nxënës dhe komuniteti i basketbollit 3×3; promovim dhe zhvillim i basketbollit 3×3 në qytete të ndryshme, përfshirë turne finale që nxisin përfshirjen dhe konkurrencën.

5. JR NBA Kosova

Target: Fëmijët në shkolla; zhvillim i aftësive bazike dhe garave në basketboll.

6. Her World, Her Rules

Target: Vajzat dhe gratë; fuqizim i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në basketboll në të gjitha nivelet.

7. FIBA Europe Youth Development Fund

Target: Lojtarët e rinj U14; përkrahje për zhvillimin e tyre dhe pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare.

8. Basketball for Good

Target: Komuniteti dhe fëmijët; përdorimi i basketbollit si mjet edukativ dhe përfshirjeje sociale.

9. PROMISE

Target: Vajzat dhe gratë; masovizimi i tyre në basketboll dhe fuqizimi i rolit të tyre në të gjitha aspektet e sportit.

Statistikat e shikueshmërisë së Superligës



Nga viti **2021** deri në **2025**, ndeshjet e Superligës së Kosovës kanë shënuar rritje të qëndrueshme të shikueshmërisë dhe interesimit të publikut. Në edicionin 2021-2022, ndeshjet e Superligës u ndoqën nga 56,250 shikues, edicion ky i zhvilluar në kushte të masave të rrepta të sigurisë për shkak të pandemisë COVID-19.

Në edicionin 2022-2023, Superliga regjistroi një rritje të ndjeshme të shikueshmërisë, duke arritur në

151,620
shikues

ndërsa në edicionin 2023-2024

145,260
shikues

Trendi pozitiv vazhdoi edhe në **edicionin 2024-2025**, ku ndeshjet e **ProCredit Superligës** u ndoqën nga

149,080
shikues

duke reflektuar rritjen e interesimit të publikut dhe zhvillimin e vazhdueshëm të basketbollit në Kosovë.

Eventet vendore & ndërkombëtare

Gjatë viteve **2021-2025**, FBK ka organizuar **51 evente ndërkombëtare dhe vendore**, duke forcuar pozicionin e Kosovës në skenën ndërkombëtare sportive dhe duke zhvilluar komunitetin e basketbollit në vend.



Gjeneratat e reja & zhvillimi i ekipeve

Gjatë ciklit 2021-2025, numri i ekipeve të regjistruara në aktivitetet e FBK-së është rritur nga 28 në 137, duke reflektuar zhvillimin e gjeneratave të reja dhe rritjen e interesit për basketbollin në Kosovë.



Zhvillimi i trajnerëve



Gjatë viteve 2021-2025, FBK ka organizuar gjithsej 11 klinika dhe kurse për trajnerë, duke përfshirë programe për trajnerët e nivelit 1 WABC, klinika për gjeneratat e reja, minibasketboll dhe kurse teknike me ekspertë ndërkombëtarë si Arik Shivek dhe Rui Alves. Numri i trajnerëve të certifikuar me Nivelin 1 WABC ka arritur në 40, duke rritur kapacitetin profesional të stafit dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e lojtarëve dhe përgatitjen e gjeneratave të reja në Kosovë.

5. KONTEKSTI STRATEGJIK



Strategjia 2026-2030
është e harmonizuar me:

Strategjinë
Shtetërore
për Sport
2025-2030;

Prioritetet e
Ministrisë për
Kulturë, Rini
dhe Sport;

Objektivat
e Komitetit
Olimpik të
Kosovës;

Strategjinë
Globale të
FIBA-s dhe
parimet e
qeverisjes së
mirë.

Në këtë kontekst, Federata e Basketbollit të Kosovës pozicionohet si:



Partner institucional
i besueshëm



Aktor zhvillimor në
sport dhe shoqëri



Organizatë e gatshme
për ngjarje madhore
ndërkombëtare.

Federata e Basketbollit të Kosovës synon të jetë një nga federatat model në rajon për qeverisje të mirë, zhvillim të qëndrueshëm dhe ndikim shoqëror përmes sportit.

6. PESË QËLLIMET E BASKETBOLLIT 3.0 2026-2030

1. Edukimi i trajnerëve – themeli i cilësisë

Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të standardizuar për edukimin e trajnerëve, në përputhje me standardet e FIBA-s, si bazë për cilësinë afatgjate të lojës.



OBJEKTIVAT

Krijimi i një databaze kombëtare të trajnerëve, të klasifikuar sipas licencave (A, B, C dhe D).

Zhvillimi i Kurrikulës Kombëtare të Trajnimit për licencat A, B, C dhe D.

Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve për trajnerët dhe licencimin e tyre.

Themelimi i Shkollës së Trajnerëve të Basketbollit të FBK-së.

Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet trajnerëve dhe referëve.

2. Zhvillimi i talenteve - rrugë e qartë drejt ekxelencës

Krijimi i një programi kombëtar që lidh basketbollin bazë, klubet, akademitë dhe ekipet kombëtare në një zinxhir të vetëm zhvillimi.



OBJEKTIVAT

Krijimi i Departamentit për Zhvillimin e Talenteve brenda Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Hartimi dhe zbatimi i një procesi të strukturuar për identifikimin e talenteve në nivel kombëtar.

Krijimi i një rruge të qartë zhvillimi të talenteve (Talent Development Pathway) nga basketbolli bazë deri te ekipet kombëtare.

3. Pjesëmarrja e vajzave & grave - barazi që fuqizon

Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në të gjitha nivelet e basketbollit, si shprehje e vlerave themelore të Basketbollit 3.0.



OBJEKTIVAT

Rritja e numrit të lojtareve femra përmes mbështetjes specifike përgjatë gjithë rrugës së zhvillimit.

Rritja e numrit të zyrtareve femra (menaxhere, drejtore, anëtare të Bordit, trajnere, refere dhe delegate teknike).

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave për barazi gjinore në të gjitha nivelet.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimit të basketbollit të vajzave dhe grave.

Zhvillimi i programeve të mentorimit për gratë dhe vajzat në sport.

Organizimi i një ngjarjeje madhore ndërkombëtare të basketbollit për femra.

4. Komuniteti i basketbollit - loja që na bashkon

Zgjerimi dhe fuqizimi i komunitetit përmes programeve të basketbollit bazë, shkollave, iniciativave urbane dhe përvojave të reja për tifozët.



OBJEKTIVAT

Zhvillimi i një Programi Kombëtar të Minibasketbollit.

Hartimi i një Plani Kombëtar për Infrastrukturën dhe Pajisjet e Basketbollit.

Zhvillimi i Programit "Basketbolli për të Gjithë (Basketball 4 All)".

5. Ekipet Kombëtare - identitet dhe përfaqësim

Forcimi i ekipeve kombëtare si kulm i sistemit zhvillimor dhe si pasqyrim i investimit afatgjatë.



OBJEKTIVAT

Krijimi i një strukture të qëndrueshme për ekipet kombëtare.

Ndërtimi i një kulture dhe identiteti të basketbollit të Kosovës.

Zhvillimi i një strategjie të monitorimit dhe komunikimit me lojtarët e diasporës.

Përmbledhje strategjike

Basketbolli 3.0

- Qëllimet, objektivat dhe ndikimi (2026-2030)

Objektivat Kryesore



- Databazë kombëtare e trajnerëve
- Rregullore dhe standarde të licencimit
- Kurrikulë kombëtare për licencat A-D
- Shkolla e Trajnerëve e FBK-së
- Bashkëpunim trajnerë-referë

01



- Departament për Zhvillimin e Talenteve
- Proces kombëtar identifikimi
- Rruga e Zhvillimit të Talenteve

02



- Rritje e numrit të lojtareve femra
- Më shumë menaxhere, drejtore, trajnere, referë dhe delegate femra
- Politika për barazi gjinore
- Fushata ndërgjegjësuese
- Programe mentorimi
- Event ndërkombëtar për femra

03



- Program Kombëtar i Minibasketbollit
- Plan Kombëtar për Infrastrukturë & Pajisje
- Programi "Basketball 4 All"

04



- Strukturë e qëndrueshme për ekipet kombëtare
- Kulturë dhe identitet kombëtar i lojës
- Strategji për monitorim dhe komunikim me diasporën

05

Ndikimi i Pritur (2030)

- Cilësi e unifikuar e trajnimit
- Rritje e profesionalizmit
- Standardizim sipas FIBA-s

- Sistem i qëndrueshëm zhvillimi
- Kalim i qartë nga baza në elitë
- Ekipë kombëtare më konkurruese

- Pjesëmarrje më e lartë e vajzave
- Fuqizim i grave në sport
- Imazh modern dhe progresiv i FBK-së

- Rritje e pjesëmarrjes bazë
- Qasje e barabartë në basketboll
- Ndikim social dhe edukativ

- Përfaqësim dinjitoz ndërkombëtar
- Integrim i talenteve nga diaspora
- Identitet i qartë sportiv i Kosovës

7. BASKETBOLLI 3x3

= ndërlidhës strategjik drejt Prishtina 2030

Basketbolli 3x3 përfaqëson një nga disiplinat më dinamike të Basketbollit 3.0. Si sport urban dhe olimpik, me rritje të shpejtë në nivel global, 3x3 ofron potencial të madh për zhvillim sportiv, rritje të pjesëmarrjes së të rinjve, si dhe për forcimin e pozicionimit ndërkombëtar të Kosovës.

Në kuadër të Strategjisë 2026-2030, Federata e Basketbollit të Kosovës e ka identifikuar basketbollin 3x3 si një prioritet strategjik kombëtar drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030 dhe përtej tyre. Për këtë qëllim, FBK ka hartuar një Plan Strategjik të veçantë për zhvillimin e disiplinës 3x3, i cili është i integruar me Planin Strategjik të përgjithshëm të Federatës.



Zhvillimi i basketbollit 3×3 gjatë periudhës 2026-2030 do të mbështetet në katër shtylla kryesore:

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes edukimit, licencimit dhe avancimit profesional të trajnerëve, referëve dhe stafit për organizimin e eventeve, në përputhje me standardet e FIBA dhe FIBA 3×3.

Zhvillimi i lojtarëve elitare dhe pjesëmarrja ndërkombëtare, përmes proceseve të strukturuar të identifikimit, kampeve zhvillimore dhe pjesëmarrjes së rregullt në garat dhe eventet zyrtare të FIBA 3×3.

Strukturimi i Ligës Kombëtare 3×3, organizimeve vendore dhe infrastrukturës, duke përfshirë zhvillimin e një kalendari të qëndrueshëm garash, organizimin e eventeve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe ndërtimin e fushave të certifikuar për 3×3.

Promovimi dhe partneritetet, përmes një qasjeje të integruar të marketingut dhe komunikimit, me fokus në rritjen e dukshmërisë, përfshirjen e komunitetit dhe ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme institucionale, komerciale dhe mediatike.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet barazisë gjinore dhe përfshirjes, me synim rritjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në basketbollin 3×3 dhe aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.

Përmes një kornize të qartë qeverisëse, mekanizmave të monitorimit dhe indikatorëve të matshëm të performancës, basketbolli 3×3 synon të zhvillohet si një disiplinë e institucionalizuar dhe e qëndrueshme, duke krijuar trashëgimi afatgjate përtej vitit 2030 dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në vizionin e Basketbollit 3.0 dhe zhvillimin e sportit në Kosovë.

8. SYNIMET 2026-2030

**Korniza e performancës
& zbatimit të Strategjisë**

Qasja ndaj synimeve 2026-2030

Synimet për periudhën 2026-2030 përfaqësojnë kornizën zyrtare të performancës dhe mekanizmin kryesor për monitorimin e zbatimit të Strategjisë "Basketbolli 3.0".

Ato nuk trajtohen si objektiva të izoluar numerikë, por si instrumente të integruara të menaxhimit strategjik, të cilat:

- Sigurojnë orientim të qartë institucional
- Mundësojnë monitorim të vazhdueshëm dhe të strukturuar të progresit
- Forcojnë llogaridhënien ndaj Bordit dhe komunitetit të basketbollit
- Mbështesin vendimmarrjen e bazuar në evidencë

Synimet 2026-2030 përmbajnë indikatorë të matshëm të performancës që funksionojnë si indikatorë kryesorë strategjikë të Federatës. Këta indikatorë

janë të ndarë sipas niveleve strategjike, zhvillimore dhe qeverisëse, në përputhje me praktikat e rekomanduara nga FIBA dhe standardet e qeverisjes së mirë në sport.

Numrat konkretë dhe objektivat shumëvjeçare për secilin indikator janë të përcaktuara në këtë dokument të Synimeve 2026-2030, si kornizë strategjike e performancës. Planet Vjetore të Veprimit fokusohen në aktivitetet dhe masat operative për arritjen e këtyre synimeve, ndërsa Plani Financiar trajton alokimin e burimeve për zbatimin e tyre. Këto dokumente mbeten të ndara, por funksionojnë në mënyrë të koordinuar dhe komplementare.

Kjo qasje siguron koherencë ndërmjet planifikimit strategjik, zbatimit operacional dhe menaxhimit financiar, duke garantuar transparencë, fleksibilitet dhe përgjegjësi institucionale gjatë gjithë ciklit 2026-2030.

Struktura e synimeve

Synimet 2026–2030 organizohen në tri nivele:



Nivel Strategjik
– treguesit kryesorë të monitoruar nga Bordi



Nivel Zhvillimor
– tregues sipas pesë qëllimeve strategjike



Nivel Qeverisës
– tregues të qeverisjes së mirë, transparencës dhe integritetit

Treguesit strategjikë kryesorë

Këta tregues pasqyrojnë performancën e përgjithshme të Federatës gjatë ciklit strategjik.

Indikatori	2025	2026	2027	2028	2029	2030
01 Të hyrat totale (€)	1,917,005.20	2.787.140	2,982,239	3,180,462	3,403,094	3,675,341
02 Përqindja e të hyrave nga sektori privat	43.46%	39.75%	40.00%	42.00%	44.00%	46.00%
03 Pjesëmarrës (gjithsej)	2363	2600	2900	3150	3500	3800
04 Pjesëmarrëse femra	510	560	620	680	750	850
05 Trajnerë të licencuar	90	110	130	160	190	220
06 Referë të licencuar	55	65	70	75	85	90
07 Klube aktive	138	149	159	165	170	175
08 Përqindja e klubeve me strukturë rinore	60%	65%	70%	75%	80%	85%
09 Tifozë në databazë	149.000	155.000	159.000	163.000	169.000	175.000
10 Pozicionimi ndërkombëtar (5×5)	86	84	81	80	78	76
11 Pozicionimi ndërkombëtar (3×3)	105	94	80	65	40	30

Synimet sipas pesë qëllimeve strategjike

1. Edukimi i trajnerëve – themeli i cilësisë

Objektivi është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të standardizuar për edukimin dhe licencimin e trajnerëve.

Treguesit përfshijnë:

- Krijimin dhe funksionalizimin e databazës kombëtare të trajnerëve
- Miratimin dhe zbatimin e rregullores së licencimit
- Themelimin dhe funksionimin e Shkollës së Trajnerëve
- Organizimin e rregullt të kurseve dhe seminareve
- Rritjen e përfaqësimit të trajnereve femra

2. Zhvillimi i talenteve – rruga drejt ekselencës

Objektivi është krijimi i një sistemi të integruar për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve.

Treguesit përfshijnë:

- Themelimin e Departamentit për Zhvillimin e Talenteve
- Organizimin e kampeve për identifikim talentesh
- Zbatimin e rrugës së strukturuar të zhvillimit të talenteve
- Krijimin e akademive rajonale
- Rritjen e ekspozimit ndërkombëtar të lojtarëve të rinj

Indikator	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Databaza kombëtare e trajnerëve	110	130	150	180	210	250
Shkolla e Trajnerëve	0	0	1	1	1	1
Trajnerë të licencuar (total)	90	110	130	160	190	220
Përqindja e trajnereve femra	8%	10%	13%	16%	19%	22%
Seminare dhe kurse vjetore	2	4	5	6	7	8

Indikator	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Departamenti për Zhvillimin e Talenteve	0	1	1	1	1	1
Kampe identifikimi talentesh	2	4	6	6	7	7
Lojtarë në programin e zhvillimit	30	50	70	100	130	160
Akademi rajonale (Qendra Zhvillimore Rajonale)	0	0	1	2	3	4
Lojtarë në liga ndërkombëtare	1	2	3	4	5	6

3. Pjesëmarrja e vajzave dhe grave – barazi që fuqizon

Objektivi është rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e basketbollit.

Treguesit përfshijnë:

- Rritjen e numrit të lojtareve aktive
- Rritjen e numrit të zyrtareve femra
- Rritjen e përfaqësimit në strukturat drejtuese
- Zhvillimin e programeve të mentorimit
- Organizimin e eventeve ndërkombëtare për femra

Indikatori	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Lojtare aktive	510	560	620	680	750	850
Zyrtare femra	7	8	9	10	12	14
Përqindja e grave në strukturat drejtuese	40%	40%	50%	50%	50%	50%
Program mentorimi	0	1	1	1	1	1
Evente ndërkombëtare për femra	1	2	3	4	5	7

4. Komuniteti dhe infrastruktura – loja që na bashkon

Objektivi është zgjerimi i bazës së pjesëmarrjes dhe fuqizimi i komunitetit.

Treguesit përfshijnë:

- Rritjen e numrit të klubeve aktive
- Zgjerimin e partneriteteve me shkolla
- Zbatimin e Programit Kombëtar të Minibasketbollit
- Zhvillimin e infrastrukturës
- Rritjen e angazhimit të tifozëve

Indikatori	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Klube aktive	138	149	159	165	170	175
Shkolla partnere	47	57	60	62	64	66
Program Kombëtar i Minibasketbollit	0	1	1	1	1	1
Shikueshmëria e kampionateve	149.000	155.000	159.000	163.000	169.000	175.000

5. Ekipet Kombëtare – identitet dhe përfaqësim

Objektivi është forcimi i ekipeve kombëtare si kulm i sistemit zhvillimor.

Treguesit përfshijnë:

- Strukturë teknike të qëndrueshme
- Integrimin e lojtarëve nga diaspora
- Përmirësimin e pozicionimit ndërkombëtar
- Arritjen e objektivave garuese

Disiplina 3x3 – prioritet strategjik

Indikator	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Pozicionimi ndërkombëtar (meshkuj)	86	84	81	80	78	76
Pozicionimi ndërkombëtar (femra)	84	82	80	78	77	75
Lojtarë nga diaspora të integruar	17	20	20	22	25	30
Arritje në gara ndërkombëtare	U20M – Vendi i 8-të	U18M – Fitues i Divizionit C U18F – Fitues i Divizionit C	U16M – Fitues i Divizionit C	Pjesëmarrje në Divizionin B - të gjitha Përfaqësueset e reja	Kosova A - Kualifikime	Kosova A Femrat Kualifikime

Indikator	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Liga Kombëtare 3x3	0	2	4	6	7	8
Turne zyrtare	15	25	35	45	55	65
Lojtarë të regjistruar	100	100	150	200	300	400
Trajnerë të licencuar 3x3	3	6	10	15	20	30
Fusha të certifikuara	3	4	6	8	15	20
Pozicionimi ndërkombëtar 3x3	105	94	80	65	40	30

Qeverisja, transparenca dhe integriteti

Indikator	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Raport vjetor publik	1	1	1	1	1	1
Audit financiar i pavarur	1	1	1	1	1	1
Përditësimi i akteve normative	17	18	18	19	20	20
Zbatimi i politikave të integritetit	1	1	1	1	1	1
Trajnime për qeverisje për klube	0	1	2	2	3	3



basketbolli 30

**është më
shumë se
një plan
zhvillimi**

DIËRZAVINJE

Strategjia 2026–2030 përfaqëson një fazë të re të pjekurisë institucionale të Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Pas një periudhe të konsolidimit organizativ dhe ndërtimit të strukturave themelore, Federata hyn në këtë cikël me qartësi strategjike, me kapacitete të forcuara dhe me një vizion të artikuluar për zhvillimin afatgjatë të basketbollit në vend.

Synimet e përcaktuara në këtë dokument nuk janë thjesht projeksione numerike. Ato janë tregues të një sistemi që po ndërtohet mbi parime të qëndrueshmërisë, qeverisjes së mirë, integritetit dhe përfshirjes.

Ky dokument reflekton përvojën e fituar ndër vite, mësimet e nxjerra nga cikli i mëparshëm strategjik dhe angazhimin për t'u përafuar me standardet më të mira evropiane në administrimin sportiv.



Basketbolli 3.0 është një deklaratë e përgjegjesisë sonë institucionale ndaj:

- lojtarëve dhe trajnerëve
- klubeve dhe komunitetit
- partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë
- brezave të ardhshëm të sportistëve

Deri në vitin 2030, synojmë që basketbolli në Kosovë të jetë:

- më gjithëpërfshirës
- më i strukturuar
- më konkurrues
- më i qëndrueshëm

Suksesi sportiv nuk ndërtohet mbi rastësinë, por mbi planifikimin, konsistencën dhe lidërshtipin e përgjegjshëm.



**Ky është angazhimi ynë.
Kjo është rruga që kemi zgjedhur.
Ky është Basketbolli 3.0.**

basketbolli30



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKI SAVEZ KOSOVA

www.basketbolli.com